

BIBLIOTEKA

8541
A37



DRITËRO

fabula
epigrame

AGOLLI

**ÇUDIRA DHE
MARREZI**



TRIBOTIMET
TOENA
TIRANE

891.993-1

854-1
1737

Dritëro Agolli

ÇUDIRA DHE MARRËZI

Fabula - Epigrame

REPUBLIKË E
SHPËRITËS
NB. LAV

54039


TOENA, 1995

Redaktor: Ferit Lamaj

Piktor: Jusuf Shahini

Në kompjuter: Artan Selenica, Blerina Bala

Drejtor botues: Fatmir Toçi



Në vend të parathënies

Fabulat, tok me përrallëzat e lezjendat, por dhe veçmas janë manifestet e para të shpirtit poetik të njeriut të tejhershëm. Të përciella ndër breza e shekuj, përmes mesazheve filozofike, moralit e humanizmit specifik, ato kanë qenë bashkudhëtarët më të urta, të mençura e të sinqerta të njerëzimit.

Është meritë e padiskutueshme e fabulistëve, qysh nga Ezopi e përkëtej, që fabula të rinjohë e të ngjisë shkallë të reja në fushë të vlerave të vërteta artistike. Por këtë zhanër kaq të këndshëm e interesant e kanë ngarë suksesshëm, thuaj, të gjithë humoristët dhe penat e shquara të rruzullit.

Fabula ka një traditë të çuditshme e të kahershme lëvrimi edhe në folklorin e në letërsinë tonë të kultivuar. Naimi, Santori, Xanoni, Çajupi, Mjeda, Negovani, Floqi, Çami, e më tutje Bulka, Çomora, Miloti e Agolli krahas gjinive të tjera letrare njomën buzën e pinë edhe nga mushti i begatë i fabulës. Pinë dhe uruan: "Të na rrojë fabula, u bëftë me nipër e mbesa!". Dhe vërtet sot fabula shqipe përvijon udhëmbarësi. Mjaft fabulistë, si Kurtiqi, Duri e të tjerë iu qepën pas dhelprës e uikut, gomarit e maçokut, njeriut e majmunit...

Dritëro Agolli, poeti ynë i shquar lirik, padyshim zë një vend nderi edhe në fushë të humorit e të satirës shqiptare. Jo vetëm proza, ku spikat dukshëm "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo", por edhe poezia e poema, fabula dhe epigrami dallojnë për vlera cilësore

të mirëfillta.

Karriera poetike e Dritëroit përfshin mëse 4 dekada. Në secilin vëllim të tij do të hasësh doemos edhe vargje fabuleskë. Me sa duket, autori lyp f'i lezetojë librat, duke ndërthurur natyrshëm lirizmin me humorin. Madje, në librin që lexuesi po merr në duar poeti ngre fort bukur "paradoksin" tjetër: humor i këndshëm fabulesk plekset herë-herë me lirizmin e thellë shpirtëror ("Rosaf e buta", "Cjapi", "Macia pret maçokët", etj.).

Fabulat dhe vargjet e tjerë humoristikë shquhen për thjeshtësi, transparencë dhe origjinalitet. Agolli është një fabulist me formim të fuqishëm. Që në titull të vëllimit autori paralajmëron lexuesin se... jetojmë në kohë të "çudirave dhe të marrëzive". Ndaj, si protagonistë të krijimeve zotërojnë personazhet-gomerë, dhelpra, ujqër e të tjerë.

Me humorin befasues e të papriturat origjinale, me batutat elegante e përvëluese ("Kau i Aliut", "Dy vëllezër dhe ujqërit", "Kallëza e misrit dhe gjembi", "Derrkuci", etj.) poeti më bën të risjell ndërmend O'Henrin e famshëm apo turkun Azis Nesin, të cilin Dritëroi e ka dhe mik.

Edhe kur konvencionet e personazhet merren nga tradita klasike, kemi shpalosje të situatave të reja, mjedise aktuale, dialogje të moderuar, çka bëjnë që krijimi të tingëllojë i freskët e i shëndetshëm ("Korbi dhe dhelpra", "Monologu i gjinkallës", etj.). Përmes çiftësimeve tradicionale autori është i zoti të zbulojë veçori të realitetit të sotëm, si dhe marrëdhënie të rëndësishme të individit me shoqërinë. Paraqitet kësisoj një vizion i qartë, na-

tyristh i mbështjellë prej një velloje trillimi dhe alegorie.

Figuracioni në vëllim paraqitet i bollshëm e i larmishëm. Do të veçoja metaforat e shumta, si dhe përsëritjen në rolin e figurës letrare, e cila i jep aq bukuri strofës e krejt krijimit. Gjithashtu, morali i përforcuar përmes distikëve përmyllës ("Luani dhe miu", "Ujku", "Mullixhiu dhe pula", "Dy pishat", etj.) i bën fabulat më të ndjeshme, më të prekshme, më jetësore.

Dritëro Agulli është mjeshtër i qëndisjes së strofës e të vargut. Do të ndeshësh nëpër fletë, që nga njërrrokëshi e gjer te njëzetrrrokëshi, vargun e rregullt e të shkallëzuar, larminë e rimave dhe të asonancave.

Fabulat brenda vëllimit janë alternuar e sinkronizuar edhe me epigramet e mikrofabulat, ku me pak vargje, me pak radhë thuhet mençurira të rralla. Le të citojmë vetëm njërin prej tyre: "Tërë natën bënte shkopinj Aliu/ Dhe betohej ta rrihte Masarin;/ Në mëngjes i thyente shkopinitë i ziu/ Dhe ndizte menduar ziarrin...".

Të shumtë janë krijuesit, që kanë gjetur frymëzim dhe kanë vjelë në vreshtin e poezisë e të prozës agolliane, përfshirë edhe autori i kësaj parathënieje. Ndonëse, syresh mosmirënjohës bastardë, pasi kanë vjelë, kanë... vjellë. Le t'i përmyll këto radhë përmes gjuhës së fabulës, me një varg aforistik: "S'pyet mali për guriçka". Dritëroi është mal.

Ferit Lamaj

2 maj 1995

KAFSHËT PËR VETE DHE PËR NJERËZIT

Krejtësisht fabula



MAÇOKU DËGJON BILBILIN

• √ty nga mbarimi i marsit a prillit
Maçoku i thoshte menduar Bilbilit:

“Këndo, or vëllaço, sa kënga këndohet,
Po mishi nga kënga aspak nuk të shtohet!

E di se në këngët je mbret fis pas fisi,
Por mua nga ti më duhet veç mishi!”

1991

KORBI DHE DHELPRA

*K*ish marrë zoti Korb pak djathë
Dhe po e hante në një degë peme.
Andej kaloi një dhelpër fustangjatë
shpejt qëndroi të bënte thashetheme.

Filloi t'i thurë lajka dhe ta prekë,
T'i flasë si dikur për bukurinë,
Po Korbi djathin vuri në një degë
Dhe heshti si strateg me pelerinë.

Pastaj i tha: - Ti kot i bie legenit,
Kërkon të marrësh djathin tim të bardhë,
Por gjuha jote është e La Fontenit;
E përsëritur dhjetra vjet me radhë.

Jetojmë shekullin e mendjes dhe progresit,
Demokracinë e tregut botëror
Dhe zemër na jep frymë e parlamentit
Për pasuri e kapital madhor...